

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CubZ Club” SH.P.K

THEMELIMI I SHOQERISE, EMERTIMI, FORMA JURIDIKE

Neni 1

- Shoqeria tregtare, e emertuar “CubZ Club” sh.p.k., themelohet sipas parashikimeve te ketij statuti, te dates 01/06/2023.
- Shoqeria “CubZ Club” sh.p.k themelohet ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

SELIA

Neni 2

- Selia e shoqerise tregtare “CubZ Club” sh.p.k gjendet ne adresen *Rruga Vaso Pasha, Rainbow Center , Kati I, Tirane, Shqiperi*. Bazuar ne parashikimet e ketij statuti dhe ligji ne fuqi, shoqeria gezon te drejten e ndryshimit te adreses se selise, si dhe te drejten e krijimit te filialeve te tjera.

KOHEZGJATJA

Neni 3

- Kohezgjatja e ushtrimit te veprimtarise ekonomike eshte e pa caktuar dhe/ose e pakufizuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE


Neni 4

- Objekti i veprimtarise tregtare “Cubz Club ”sh.p.k. është: Sherbime bar-pub, katering, klub nate, diskoteke, organizim eventesh, etj. Import-eksport materialesh robotike per krijim atmoshere eventesh artistike, aparatura teknologjise LED, sistem ndricimi dhe sistem elektronik i drejimit te ndricimit te telekomanduar, karrike dhe tavolina banak dhe mobilie te tjera per zhvillim aktiviteti bar – pub - lokal nate – bistro – lounge - club, impiante fonie dhe impiante autoporlantesh, spote reklamuese, reklama. *Si dhe cdo veprmtari tjeter tregtare te lejuar nga legjislacioni i Republikes se Shqiperise.*

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

- Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 100,000 leke, indare ne 3 kuota. Shoqeria mund ta shtoje ose pakesoje kapitalin e saj sipas parashikimeve te ketij



statutit dhe ne perputhje me vendimi te Asamblese se Ortakeve. Ortaket e shoqerise renditen si me poshte vijon:

- 1- **Z. Ermal Peti**, i datelindjes 18/08/1987, lindur dhe banues ne Tirane, me Nr. Personal ID I70818070R, zoteron 50 % ose 1 kuote ne vlore 50,000 leke.
- 2- **Z. Marsel Zadrima**, i datelindjes 26/10/1978, lindur dhe banues ne Tirane, me Nr. Personal ID H81026094M, zoteron 25 % ose 1 kuote ne vlore 25,000 leke.
- 3- **Z. Frensi Zadrima**, i datelindjes 07/12/1982, lindur dhe banues ne Tirane, me Nr. Personal ID I21207103O, zoteron 25 % ose 1 kuote ne vlore 25,000 leke.

TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 6

- Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortaku qe kerkon te tjetersoje (shese) kuotat e tij duhet te njoftoje me shkrim administratorin e shoqerise, i cili njofton menjehere Asamblene e Ortakeve per cmimin e shitjes. Ortaket ekzistues gezojne te drejten e parablerjes.
- Nese brenda 30 diteve, nga e nesermja e komunikimi i ofertes, ortaket nuk shprehin, me shkrim, interesin e tyre per blerjen kuotave te kapitalit, atehere kuotat oferte-shitje mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

TRANSFERIMI TEK PJESETARI I FAMILJES

Neni 7

- Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme mes anëtarëve të familjes si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve.

TRANSFERIMI I PJESES SE KAPITALIT NE RRUGE TRASHEGIMIE

Neni 8

- Ne rast vdekje te ortakut, kuoten titullare te te ndjerit e perfitojne trashegimtaret e tij ligjor.

FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 9

- Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te realizohet ne formen e aktit notarial dhe ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak ekzistues i shoqerise, duhet te deklaroje shprehimi qe eshte njohur me statutin e shoqerise dhe se eshte dakord me parashikimet e tij.

ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Neni 10

- Kapitali themeltar mund te rritet pa kufizim, nje ose disa here. Vendimi per zmadhimin e kapitalit do te merret nga Asambleja e Ortakeve, me votim e ortakeve qe gezojne jo me pak se $\frac{3}{4}$ e kuotave te kapitalit. Ortaket kane te drejte te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit sipas kuotave respektive.

ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Neni 11

- Kapitali themeltar mund te zvogelohet, nje ose disa here, brenda limiteve te percaktuara nga lijni ne fuqi. Vendimi per zvogelimin e kapitalit do te merret nga Asambleja e Ortakeve, me votim e ortakeve qe gezojne jo me pak se $\frac{3}{4}$ e kuotave te kapitalit. Ortaket kane te drejte te nenshkruajne zvogelimin e kapitalit sipas kuotave respektive.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 12

- Ortaku ka te drejte te informohet mbi cdo ceshtje qe lidhen me administrimin e shoqerise, performancen e veprimitarise se saj, te njihet me bilancin vjetor, etj. Ortaku (jo administrator) mund ti drejtohet administratorit te shoqerise me pyetje lidhur mbi aktivitetin e shoqerise.
- Ortaku nuk mund te marre hua nga shoqeria, paradhenie apo te behet garant per detyrimet monetare te paleve te treta.
- Ortaku ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve personalisht, ose permes perfaqesuesit te tij, te pajisur me prokure te posacme.
- Ortaku duhet te ushtroje te drejtat e tij politike, si te drejten e votes, ne perputhje me parashikimet e ketij statutit dhe legjislacionit te Republikes se Shqiperise.
- Ortaku ka te drejte te paraqese propozime per rendin e dites se mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.
- Ortaku ka te drejte te marri pjese ne organet e shoqerise.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 13

- Asamblea e Ortakeve;
- Administratori.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 14

- Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Vendimet e saj ne maxhorance (50 + 1%) jane te detyrueshme edhe per ortaket e tjere.
- Nese shoqerise do te kete periudha ne te cilat do te kete nje ortak te vetem, te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Ortakeve do te ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e kaluara te ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, datat e te cilit nuk mund te ndryshohen apo fshihen.

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE


Neni 15

- Asambleja eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise, i cili vendos per:
 - Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise.
 - Miratimin e bilancit vjetor, ndarjen e fitimit sipas % se kuotave dhe caktimin e modaliteteve per plotesimin e humbjeve nese ndodhin.
 - Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
 - Ndryshimin e statutit.
 - Emerimin, heqjen dhe shperblimin e administratorit dhe te ekspertit kontabel te autorizuar.
 - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
 - Ceshtje te tjera, te parashikuara nga legjislationi i Republikes se Shqiperise.

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE DHE VOTIMI

Neni 16

- Asambleja e Ortakeve thirret ne raste te percaktuara nga Ligji n.9901 de 14/04/2008 i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, ose ne dispozitat e Statutit, apo ne cdo rast qe konsiderohet i nevojshem per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e Asamblese do te behet te pakten nje here ne vit.
- Asamblea e Ortakeve do te thirret nga Administratori ose nga Ortaket sic eshte parashikuar ne Ligjin n.9901 i 14/04/2008, i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014.
- Asamblea mund te thirret dhe/ose mbahet edhe ne rruge telematike.
- Asambleja e Ortakeve do te thirret nese, sipas bilancit vjetor ose nga raportet e ndermjetme financiare, rezulton qe ekzistojne rreziqe qe aktivitetet e Shoqerise te mos i mbulojne detyrimet e nevojshme brenda tre muajve ne vijim.
- Asambleja thirret kur propozohet tjetersimi i aseteve te shoqerise, qe kane nje vlera me te larte se 5 perqind i vleres totale te aseteve te saj.



- Asambleja e Pergjithshme do te thirret kur Shoqeria, branda dy viteteve te para pas themelimit, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlore me te larte se 5 perqind te aseteve te Shoqerise.
- Vendimet ne mbledhjen e Asamblese do te merren pas plotesimit te kuorumit prej 50 + 1% te kuotave te kapitalit te shoqerise. Ky eshte kuorum i nevojshem per nje vendimarrje te vlefshme, pervec nese, sipas parashikimeve te ketij statuti, do te nevojitet nje kuorum me i larte.

ADMINISTRATORI
Neni 17

- Shoqeria perfaqeshet nga administratori. Ne emer te shoqerise nenshkruan administratori.

EMERIMI I ADMINISTRATORIT
Neni 18

- Administratori i Shoqerise "CubZ Club" sh.p.k. emerohet nga Asambleja e Ortakeve me shumicen e votave te ortakeve, pjeset e te cilave perfaqesojne mbi 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise. Administratori mund te jete ortak ne shoqeri ose jo.
- Asambleja e Ortakeve mund te revokoje emerimin me shumice votash.
- Ne fazen e formimit emerohet administrator z. **Frensi Zadrima**, me nr. Personal I21207103O, lindur me date 07/12/1982, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, per nje afat 5 vjecar.
- Specimenti i Firmes se Administratorit: Frensi Zadrima (Emer,
Mbiemer, Firme).

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT
Neni 19

- Administratori ka te dreje te veproje ne emer te shoqerise dhe ne mbrojtje te interesave te saj.
- Administratori drejton e kontrollon veprimtarine e shoqerise tregtare.
- Administratori perfaqson shoqerine tregtare perpara te treteve.
- Administratori nenshkruan kontrata ne emer e per logari te shoqerise dhe sigurohet per zbatimin e tyre.

- Administratori eshte perjegjes per zbatimin e politikave tregtare te miratuara nga Asambleja e Ortakeve.
- Administratori ushtron cdo kompetence qe i njeh ky statut dhe ligji ne fuqi per administrimin e shoqerise.
- Administratori raporton dhe i pergjigjet Asamblese se Ortakeve per cdo ceshtje qe lidhet me administrimin e shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.

DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Neni 20

- Administratori i shoqerise ka detyre te kryeje funksionin e tij me kujdesin e duhur dhe te ruaje sekretet tregtare, informacionet konfidenciale, zbulimi i te cilave mund te shkaktoje deme per shoqerine. Ky detyrim do te kete fuqi juridike edhe mbas perfundimit te funksionit te administratorit.
- Administratori nuk mund te marre hua nga shoqeria, te miratoje ne emer te shoqerise paradheniet ose te behet garant per detyrimet ndaj personave te trete.
- Administratori ka detyre qe te paken nje here ne vit t'i paraqese asamblese reportin mbi veprimtarine e shoqerise dhe gjendjen e pasurise se saj.

BILANCI VJETOR, NDARJA E DIVIDENTIT

Neni 21

- Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit finanziar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- Sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi, dhe me shumice votash prej $\frac{3}{4}$ te kuotave te kapitalit, Asambleja e Ortakeve vendos ndarjen e dividentit per secilin ortak.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 22

- Mosmarreveshjet midis ortakeve do te zgjidhen me pajtim mes tyre. Nese kjo nuk do te jete e mundur, kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane

SHKRIRJA E SHOQERISE

Neni 23

- Shoqeria shkrihet:
 - diten e shenuar ne Vendimin e Asamblese per shkrimen e shoqerise.

- diten e shenuar ne Vendimin e gjykates per shkrirjen e shoqerise
- ne raste te tjera, te cilat vendosen me ligj.

GJUHA
Neni 24

- Ky statut eshte hartuar ne Tiranë me date 01/06/2023 ne kater kopje originale ne Gjuhen Shqipe dhe nuk ka asnje verejtje nga ortaket e shoqerise.

DISPOZITA TE FUNDIT
NENI 25


- Persa nuk eshte shprehur ne kete statut eshte komptence e Asamblese se Ortakeve qe te beje plotesimin e dispozitave te ketij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave te cilat behen te pavlefshem.

ORTAKET THEMELUES

Z. Ermal Peti



Z. Marsel Zadrima



Z. Frensi Zadrima

